

Udhëzues për familjet që shpërngulen në Finlandë dhe në Turku

Mirë se vini në Turku! Mirë se vini në shkollë!

Ky udhëzues të tregon se si është shkollimi në Finlandë dhe në Turku, si dhe çfarë përmbajtjesh, të drejtash dhe detyrimesh lidhen me të.

Udhëzues për familjet që shpërngulen në Finlandë dhe në Turku	1
Mirë se vini në Turku! Mirë se vini në shkollë!	1
Cili është qëllimi/synimi i mësimit përgatitor?	2
Në shkollë, nxënësit i bëhet një program mësimi.....	2
Në cilën shkollë të Turkut ka mësim përgatitor?	2
Gjëra të rëndësishme në shkollën finlandeze	2
Rrobat shkollore	3
Çfarë është e rëndësishme në shkollë?.....	3
Çfarë duhet të bëjë nxënësi?	3
Çfarë duhet të bëjë kujdestari?.....	4
Çka është Wilma?	4
Dëshiroj që fëmija ose i riu im të marrë pjesë në mësimin përgatitor. Çfarë të bëj?	4
Apliko kështu	4

Mirë se vini në Turku! Mirë se vini në shkollë!

Çfarë është mësimi përgatitor?

Mësimi përgatitor për arsimin bazë është i destinuar për fëmijët dhe të rinjtë e moshës 7–16 vjeç. Në mësimin përgatitor mësohet gjuha finlandeze.

Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë që jetojnë në Finlandë mund të ndjekin mësimin përgatitor, nëse ende nuk flasin gjuhën finlandeze.

Mësimi përgatitor do të thotë mësim në të cilin nxënësi mëson gjuhën finlandeze dhe fiton aftësi për të mësuar lëndë të ndryshme.

Gjuha e mësimit në mësimin përgatitor është finlandishtja.

Mësimi mbahet 23–26 orë në javë.

Mësimi zgjatë rreth një vit.

Pas mësimit përgatitor, nxënësit kalojnë në arsimin bazë/fillor ose në studime të shkallës së dytë në shkollë të mesme.

Në zgjedhjen e shkollës së ardhshme ndikojnë moshja e nxënësit dhe sfondi i shkollimit të tij .

Nxënësit kanë grupin e tyre dhe mësuesen e tyre.

Në grup ka shpesh edhe një ndihmëse të vijimit të shkollës, e cili ndihmon nxënësit gjatë orëve

mësimore.

Cili është qëllimi/synimi i mësimi përgatitor?

Qëllimi i mësimi përgatitor është:

1. nxënësi të njihet me shkollën finlandeze
2. nxënësi të mëson gjuhën finlandeze
3. të kalojë gradualisht nga mësimi përgatitor në arsimin bazë.

Në shkollë, nxënësit i bëhet një program mësimi.

Secilit nxënës i bëhet një program mësimi. Programi i mësimi është një plan në të cilin tregohet cilat janë synimet e shkollimit të nxënësit. Mësuesja, nxënësi dhe kujdestari i tij bëjnë programin e mësimi së bashku.

Në cilën shkollë të Turkut ka mësim përgatitor?

Mësimi përgatitor ofrohet në shumë shkolla të Turkut.

Nëse mësimi përgatitor nuk ofrohet në shkollën më të afërt të nxënësit, atëherë ai duhet të udhëtojë në një shkollë tjetër.

Nxënësi mund të shkojë në shkollë në këmbë, me biçikletë ose me autobus.

Nëse rruga për në shkollë është e gjatë, nxënësi mund të marrë biletë udhëtimi.

Nxënësi merr biletën e udhëtimi nëse rruga e tij për në shkollë është mbi 5 kilometra.

Gjëra të rëndësishme në shkollën finlandeze

Çfarë duhet të marrë nxënësi me vete në shkollë?

- Çantë shpine dhe kuti lapsash
- Rroba të rehatshme dhe elastike për orën e edukatës fizike.

Çfarë merr nxënësi falas nga shkolla?

- Librat dhe fletoret
- Lapsin dhe gomën
- Drekën.

Çfarë mësohet në shkollën fillore finlandeze?

- gjuhë finlandeze
- matematikë
- edukatë fizike
- muzikë

- art figurativ
- anglishtja
- suedishtja
- biologji dhe gjeografi
- fizikë dhe kimi
- histori dhe dituri shoqërore
- mësim shëndetësor
- amvisëri
- punë dore
- feja ose filozofi e jetës

Të gjitha lëndët nuk mësohen në mësimin përgatitor ose në të gjitha klasat.

Mësuesja jep orarin e mësimin.

Në orarin e mësimin shihet se kur fillon dhe përfundon shkolla në ditë të ndryshme.

Nxënësi mund të mësojë edhe gjuhën e tij amtare pas orarit të shkollës.

Për më tepër mund të pyetni mësuesen.

Viti shkollor fillon në javën e dytë të gushtit dhe përfundon në javën e 22-të të vitit.

Gjatë vitit shkollor ka pushim vjeshte, pushim i krishtlindjes, pushim dimëror dhe disa ditë të tjera pushimi.

Rrobat shkollore

Në shkollë nuk ka uniformë shkollore. Përdor rrobat e tua në shkollë, të cilat janë të rehatshme për të mësuar.

Gjatë pushimeve mes dy orëve, nxënësit shkojnë jashtë.

Merr me vete rrobat e jashtme sipas motit.

Për orën e edukimit fizik ke nevojë për rroba të rehatshme dhe elastike.

Mësuesja tregon nëse jeni jashtë apo brenda dhe çfarë lloj rrobash keni nevojë.

Çfarë është e rëndësishme në shkollë?

Mësimi është gjëja më e rëndësishme në shkollë.

Është e rëndësishme që të gjithë të ndihen sa më mirë në shkollë.

Ji shok i mirë klase dhe i sjellshëm me të gjithë.

Gjatë orëve mësimore bashkëpunon me të gjithë shokët e klasës.

Diskriminimi është i ndaluar. Të gjithë kanë të njëjtat të drejta dhe mundësi.

Trajtimi i ndryshëm bazuar në gjininë, fenë, ngjyrën e lëkurës, gjuhën, shtetësinë, orientimin seksual, prejardhjen, moshën dhe opinionin është i ndaluar.

Vini në shkollë çdo ditë.

Nëse nxënësi mungon (p.sh. për shkak të sëmundjes), prindi/kujdestari e njofton mësuesen me mesazh.

Trego mësueses për mungesën sa më shpejt që të dish për të.

Çfarë duhet të bëjë nxënësi?

Ji shok i mirë klase dhe i sjellshëm me të gjithë.
Bëj detyrat e shkollës me kujdes dhe në kohë.

Çfarë duhet të bëjë kujdestari?

Kujdestari do të thotë nëna, babai, instruktori ose një tjetër i rritur me të cilin banon fëmija.
Kujdestari është një i rritur që kujdeset për fëmijën.
Kujdestari siguron që nxënësi të shkojë në shkollë dhe të bëjë detyrat e shtëpisë.
Kujdestari mund të ndihmojë nxënësin, por nuk bën gjërat në vend të tij.

Çka është Wilma?

Wilma është sistemi i brendshëm i mesazheve dhe informacionit i vetë shkollës.
Nga mësuesja i merr kredencialet për Wilma.
Në Wilma mund të shikosh orarin, mesazhet, detyrat e shtëpisë, provimet dhe informacionet e tjera të rëndësishme.
Në Wilma mund të përgjigjesh dhe të dërgosh mesazh mësueses.

Lista e kujtesës për kujdestarin:

- Kontrolllo çdo ditë që fëmija yt ka bërë detyrat e shtëpisë.
- Kontrolllo që të gjitha rrobat dhe gjërat për ditën e ardhshme janë gati.
- Njofto mësuesin kur fëmija mungon nga shkolla (sëmundje, vizitë tek mjeku, etj.).
- Mbështet dhe inkurajo fëmijën në shkollim.
- Kërko ndihmë nga shkolla nëse nuk e di se si ta mbështesësh fëmijën.

Dëshiroj që fëmija ose i riu im të marrë pjesë në mësimin përgatitor. Çfarë të bëj?

Apliko menjëherë për një vend në mësimin përgatitor për fëmijën ose të riun sapo të arrijnë në Finlandë.

Mund të aplikosh gjithashtu sapo të dish se kur fëmija ose i riu do të vijë në Finlandë.

Mund të aplikosh për vend në mësimin përgatitor gjatë gjithë vitit.

Apliko kështu

Për nxënësin mund të aplikohet për vend në mësimin përgatitor përmes formularit të regjistrimit të nxënësve që gjendet në faqen e internetit të qytetit Turku.

Aplikimi i përfunduar dërgohet me email të Tenna Käpyläs (tenna.kapyla@turku.fi).